



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI”
VLORE

OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPERNDARJES / DEGA VLORE

NR. PROT. 2524/2 VLORE, 15.10. 2025 NR. PROT. 1439 VLORE, 30.10. 2025

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

UNIVERSITETIT “ISMAIL QEMALI” VLORE

&

OPERATORI I SISTEMIT TË SHPËRNDARJES / DEGA VLORE

Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, si institucion publik me statusin “Person Juridik Publik” përfaqësuar nga **Prof. Dr. Aurela Saliaj në cilësinë e Rektorit** si përfaqësuesi ligjor për çështjet akademike dhe protokollare dhe autoriteti më i lartë akademik,

&

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (këtëj e tutje OSSH), **përfaqësuar nga z. Vasian Konomi, në cilësinë e Drejtorit.**

Me qëllim zhvillimin e praktikave profesionale, interesin e përbashkët, duke vlerësuar kontributin e deritanishëm dhe dëshirën e mirë për të konsoliduar bashkëpunimin e përbashkët ndërinstitucional, palët bien dakort të lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë “Marrëveshja”)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Neni 1

Qëllimi i marrëveshjes

Kjo marrëveshje ka për qëllim, bashkëpunimin ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe OSSH në kuadër të zhvillimit të praktikave profesionale për studentët e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.

Neni 2

Baza ligjore

Zhvillimi i praktikës mësimore bazohet në ligjin 80/2015, "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, ligji Nr.10 171, datë 22.10.2009 "Për profesionet e rregulluara në Republikën e Shqipërisë", VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 "Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor".

Neni 3

Mënyra e Bashkëpunimit

Marrëveshja ka për qëllim bashkëpunimin e ndërsjelltë ndërmjet Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe OSSH/dega Vlorë, duke përfshirë:

- Zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve të UV-së në programet e studimit Bachelor dhe Master.
- Sigurimin e ambienteve të përshtatshme brenda territorit të institucionit për realizimin e seancave mësimore të praktikave profesionale.
- Realizimin e praktikave (mësimore dhe profesionale) të programeve të fushave të ndryshme, të ofruara nga Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
- Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta për Edukimin në Vazhdimësi (konferenca, simpoziume, trajnime, workshop-e).

Neni 4

Sfera e bashkëpunimit

Pjesë e këtij bashkëpunimi do të jenë:

- Njësitë kryesore nga të cilat përbëhet Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë.
- OSSH Dega Vlorë.



Ky bashkëpunim përfshin realizimin e programeve mësimore në dy cikle studimi:

- Cikli i parë i studimeve të nivelit Bachelor.
- Cikli i dytë i studimeve të nivelit Master.

Palët nënshkruese do të bashkëpunojnë në këto fusha:

- Leksionet dhe seminarët në module mësimore të caktuara.
- Praktikat mësimore
- Praktikat profesionale
- Detyrat e kursit dhe Tema Diplomash.

Neni 5

Detyrimet e palëve

1. OSSH/Dega Vlorë , merr përsipër:

- 1.1 Lejimin e studentëve të UV-së, për të zhvilluar praktikën mësimore pranë këtij institucioni.
- 1.2 Krijimin e kushteve për kryerjen e aktivitetetve të përcaktuara në nenin 4(katër) të kësaj marrëveshjeje, që do të ndërmeren nga ana e Universitetit ‘Ismail Qemali’ Vlorë.
- 1.3 Caktimin e një personi përgjegjës për zhvillimin e praktikës mësimore i cili do të bëjë orientimin, mbikqyrjen, mentorimin e studentëve gjatë gjithë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.
- 1.4 Raportimin pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë nëse do të ketë problematika të ndryshme që mund të jenë krijuar nga ana e studentëve të hasura gjatë periudhës së zhvillimit të praktikës mësimore.

2. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë, merr përsipër:

- 2.1 Dorëzimin, (para fillimit të praktikës mësimore), pranë çdo Institucioni, të listës emërore (firmosur nga Drejtuesi i Njesisë Bazë) të studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore.
- 2.2 Depozitimin pranë çdo Institucioni të dokumentit justifikues ligjor në lidhje me derdhjen e kontributeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale të të gjithë



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



studentëve që do të zhvillojnë praktikën mësimore për të gjithë periudhën e praktikës mësimore, në zbatim të VKM – së Nr.77, datë 28.01.2015 “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.

2.3 Orientimin e studentëve në lidhje me respektimin e rregullave të secilit Institucion.

- 3 Palët kanë detyrimin të mbrojnë të dhënat personale që përpunohen dhe në mënyrë të veçantë për të dhënat sensitive, në përputhje me ligjin Nr. 9887, datë 10.3.2008, i ndryshuar “Për mbrojtjen e të dhënave personale”.

Neni 6

Respektimi i marrëveshjes

Institucionet bien dakord që, nëse për arsye grevash, ose mosmarrëveshjes të punës, motit të keq, “Fuqisë Madhore” ose shkaqeve të tjera objektive të cilat janë të pashmangshme, shkaktuar përtej mundësisë që kanë ato për t’i kontrolluar, në mbështetje të këtij paragrafi, nëse institucionet nuk janë të afta të kryejnë detyrimet e tyre, kjo pamundësi e tyre nuk do të konsiderohet si prishje e Marrëveshjes.

Neni 7

Mirëbesimi

1. Universiteti “Ismail Qemali” Vlorë dhe OSSH/ Dega Vlorë do të respektojnë parimin e mirëbesimit të ndërsjelltë.
2. Palët duhet të rruajnë dhe të administrojnë me mirëbesim të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të shkëmbyera prej tyre në lidhje me këtë Marrëveshje.

Neni 8

Afati i marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje do të lidhet për një kohëzgjatje 5(pesë) vjeçare nga data e nënshkrimit
2. Pas përfundimit të datës së përcaktuar në paragrafin e mësipërm, kjo marrëveshje mund të zgjatet bazuar në një marrëveshje të përbashkët me shkrim.
3. Marrëveshja mund të zgjidhet nga secila Palë, nëpërmjet dërgimit të një njoftimi me shkrim Palës tjetër, të paktën 6(gjashtë) muaj përpara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Neni 9
Nënshkrimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj.
2. Kjo marrëveshje është hartuar në 3(tre) kopje origjinale në gjuhën Shqipe, nga 1(një) kopje do të depozitohen në Rektoratin e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë dhe Njësinë Kryesore, 1(një) kopje do të depozitohet në OSSH, Dega Vlorë.

PËR

UNIVERSITETIN
"ISMAIL QEMALI" VLORE

REKTOR

PROF. DR. AURELA SALIAJ



PËR

OPERATORI I SISTEMIT TË
SHPËRNDARJES

